



Nr. 52 prot.

Himarë, më 27. 06. 2023

**PROCESVERBAL I ZBARDHUR NGA ORGJINALI MBI ZHVILLIMIN E  
MBLEDHJES SË KONSTITUIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË DATË  
27.06.2023**

I mbajtur sot më datë 27.06.2023, ora 11:00, në sallën e Këshillit Bashkiak Himarë mbi zhvillimin e mbledhjes të konstituimit të Këshillit Bashkiak Himarë, pas zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023, mbështetur në vendimin e kolegjit zgjedhor Nr. 599 datë 25.05.2023 me emrat e këshilltarëve fitues si më poshtë:

**1. Në mbledhje marrin pjesë këshilltarët:**

Gjergji Iliadhi, Elisabeta Lamaj, Nikolin Laska, Dhimitër Kapaj, Loreta Isufi, Thodhori Foto, Nertila Husi, Mirka Gjiçali, Artionil Shirokaj, Milto Nika, Aleks Llazari, Silva Burbo, Fuat Mati, Timoleo Gërdhuqi, Qirjako Mërkuri, Lenica Kocani, Miltiadh Prifti, Maks Vlashi, Artan Bala, Thëllëza Kokaveshi, Afrovita Dhimojani.

**2. Mungojnë: Nuk mungon asnjë këshilltarë.**

Në mbledhje marrin pjesë të ftuar: I Deleguar për qarkun Vlorë Z. Blendi Klosi, deputet i qarkut Vlorë Z. Vullnet Sinaj.

Përfaqësues nga Ministria e Brendshme Znj. Elena Kutulla.

Prefekti I Qarkut Vlorë Z. Flamur Mamaj, Kryetari i Këshillit Qarku Vlorë Z. Ervis Moçka. Deputet Z. Vangjel Dule, Ambasadorja e Greqisë Znj. Konstantina Kamitsi, përfaqësues të medias, përfaqësues të shoqëris civile, etj.

**3. Mbledhja zhvillohet me këtë rend dite:**

Fjala e hapjes nga sekretari i Këshillit Bashkiak dhe përshëndetjet e rastit.

a-Përshëndet

b-Sekretari i Këshillit lexon vendimin e KQZ dhe përbërjen e këshillit të Bashkisë (emër,mbiemër, forcën politike që përfaqëson, rendin e ditës)

c- Sekretari fton këshilltarin më të vjetër në moshë për të drejtuar mbledhjen përkohësisht deri në zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit.

Mbledhjen e drejton këshilltarja më e vjetër në moshë Znj. Lenica Kocani.

### **I.Konstituimi i Këshillit Bashkiak**

a- Zgjedhja e komisionit të vërtetimit të mandateve sipas propozimeve të grupeve të këshilltarëve,miratohet nga këshilli me votim të hapur,

Grupi i këshilltarëve të partisë socialiste këshilltarja Mirka Gjiçali propozon:

1. Gjergji Iliadhi
2. Nertila Husi

Nga opozita, Bashkë Fitojmë këshilltarja Afrovita Dhimojani propozon:

1. Thëllëza Kokaveshi

**Hidhet në votim komisioni i mandateve: miratohet ne 21 vota pro. Merret vendimi:**

**VENDIMI NR.26. DATË 27.06.2023 “Për ngritjen e komisionit të vërtetimit të mandateve”.**

- 1.Gjergji Iliadhi - Kryetar
- 2.Thëllëza Kokaveshi - Zv/kryetar
- 3.Nertila Husi - Sekretar

b. Këshilltari më i vjetër i jep fjalën kryetarit të verifikimit të mandateve për të drejtuar punën e komisionit,për të hartuar raportin dhe për ta lexuar para këshillit.

c. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të komisionit të mandateve.

Komisioni i mandateve shqyrton dokumentin përkatës të KQZ dhe kryetari i komisionit lexon me zë të lartë para Këshillit raportin e komisionit për vleshmërinë e mandateve të këshilltarëve, mandati i të cilëve është i vleshëm.

Kryesuesi i mbledhjes fton këshilltarët e pranishëm të votojnë raportin e Komisionit të Mandateve me emrat e këshilltarëve të mandatuar si më poshtë:

1. Afrovita Dhimojqi, 2. Timoleo Gërdhuqi, 3. Silva Burbo, 4. Miltiadh Prifti, 5. Lenica Kocani, 6. Fuat Mati, 7. Thëllëza Kokaveshi, 8. Gjergji Iliadhi, 9. Elisabeta Lamaj, 10. Nikolin Laska, 11. Mirka Gjiçali, 12. Dhimitër Kapaj, 13. Loreta Isufi, 14. Thodhori Foto, 15. Nertila Husi, 16. Artionil Shirokaj, 17. Milto Nika, 18. Aleks Llazari, 19. Qirjako Mërkuri, 20. Artan Bala, 21. Maks Vlasi

2. Merret:

### **VENDIMI NR. 27 DATË 27.06.2023 "Për vërtetimin e mandateve të këshilltarëve"**

b. Pas vërtetimit të mandateve kryesuesi i mbledhjes lexon tekstin e betimit të këshilltarëve. Teksti i betimit "Betohe në nderin tim se do të kryej me ndergjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve.

Betohe, se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetësave të Bashkisë Himarë dhe do punoj me ndershmëri dhe përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqënies së tyre".

Secili nga këshilltarët ngrihet në këmbë me dorën mbi kushtetutë dhe betohet. Këshilltarët nënshkruajnë tekstinë e betimit.

### **2. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit të Bashkisë.**

Sekretari njofton fillimin e procedurës së zgjedhjes së Kryetarit të Këshillit

- a- Propozimet për kandidaturat për kryetar këshilli nga këshilltarët (prezantim i kandidatëve)
- b- Ngritja e komisionit të votimit (tre anëtarë)

1. Milto Nika - Kryetar

2. Mirka Gjiçali - Nënkryetarë

3. Silva Burbo - Sekretar

Hidhet në votim dhe miratohet me votim të hapur.

### **VENDIMI NR. 28 DATË 27.06.2023 "Për zgjedhjen e komisionit për Kryetarin e Këshillit".**

Kryesuesi i mbledhjes kërkon propozimet për Kryetar Këshilli nga grupet politike.

Grupi socialist: Këshilltari Gjergji Iliadhi propozon për Kryetar Këshilli Z. Dhimitër Kapaj.

Bashkë Fitojmë: Propozojnë për Kryetare Këshilli Znj. Afrivita Dhimojani.

Kryesuesi i mbledhjes, hedh në votim të dy kandidaturat, votimi bëhet i fshehtë.

Komisioni i votimit harton procesverbalet dhe si përfundim kryetari i komisionit lexon me zë të lartë rezultatet. Z. Dhimitër Kapaj zgjidhet me 13 vota pro, Znj. Afrivita është votuar me 8

vota pro. Drejtuesi i mbledhjes i uron suksese në detyrën Kryetarit të Këshillit dhe e fton të drejtojë mbledhjen në vijimësi.

**Kryetar Këshilli zgjidhet Z. Dhimitër Kapaj.**

**Miratohet: VENDIMI NR. 29 DATË 27.06.2023 “Mbi zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Bashkia Himarë”, Z. Dhimitër Kapaj**

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit të Bashkisë Z. Dhimitër Kapaj.

### **3. Zgjedhja e zëvendëskryetarit/rëve të Këshillit Bashkiak**

Miratimi me votim të hapur i numrit të zëvendëskryetarëve të Këshillit Bashkiak.

Këshilli dakortëson që këshilli të ketë dy zëvendëskryetar.

Kryetari i këshillit kërkon propozimet:

Grupi socialist: Nikolin Laska propozon për zëvendëskryetar këshilli Z. Milto Nika

Grupi opozitar Bashkë Fitojmë: propozojnë për zëvendëskryetar këshilli Z. Timoleo Gërdhuqi.

Kryetari i Këshillit hedh në votim të dyja propozimet, votimi bëhet i hapur me miratimin e këshillit.

**Hidhet në votim, miratohet me 21 vota pro.**

**VENDIMI NR. 30 DATË 27.06.2023 “MBI ZGJEDHJEN E ZËVËNDËSKRYETARËVE TË KËSHILLIT BASHKIA HIMARË”.**

**Z. Timoleo Gërdhuqi me 21 vota pro**

**MIRATOHET VENDIMI NR. 31 DATË 27.06.2023 “MBI ZGJEDHJEN E ZËVËNDËSKRYETARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAKË HIMARË”.**

**Z. Milto Nika me 21 vota pro**

### **3. Ceremonia e marrjes-dorëzimit të detyrës së Kryetarit të Bashkisë**

Kryetari i Këshillit lexon pikën e rendit të ditës.

Kryetarja e grupit Bashkë Fitojmë merr fjalën dhe kërkon: të lexohet vendimi i KQZ dhe vendimi i gjykatës për Z. Alfred Beleri, i cili nuk është prezent në sallën e mbledhjes dhe mungesën e tij e ka arsyetuar dhe drejtuar me shkrim këshillit vetë Z. Alfred Beleri.

Kryetari këshillit lexon nenin 60 pika 3 e ligjit të vetëqeverisjes vendore 139/2015 “Shpallja e vleshmërisë së mandatit të kryetarit të Bashkisë bëhet në mbledhjen më të parë të Këshillit Bashkiak përkatës, ku kryetari bën betimin sipas formulës të përcaktuar në nenin 50 të këtij ligji dhe e nënshkruan atë”.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani paraqet kërkesë këshillit: Të miratohet në këshill dhënia e lejes, të jetë prezent ose nëpërmjet rrjeteve sociale, një mundësi për bërjen e betimit për Z. Alfred Beleri.

Kryetari këshillit: Kërkesa duhet të depozitohet dhe protokollohet në sekretarinë e Bashkisë përpara se të shqyrtohet në këshill. Afrovita Dhimojani se bashku me këshilltarët e BF, insitojnë që kjo kërkesë të miratohet në këshill në këtë mbledhje.

Kryetari i Këshillit e hedh në votim kërkesën dhe nuk miratohet. Vazhdojnë debate dhe zhurmë në sallën e mbledhjes.

Mer fjalën këshilltari Milto Nika: rendi i ditës në konstituimin e këshillave Bashkiak është standart dhe nuk mund të shtojmë dhe të heqim asnjë pikë në përmbajtje.

Mer fjalën këshilltari Qirjako Mërkuri: Të vazhdojmë me rendin e ditës pasi sot nuk protokollohen kërkesa.

Debate dhe zhurmë në sallë nga këshilltarët dhe pjesëmarrësit në sallë.

Kryetari Këshillit: vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës.

#### **4. Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit të Bashkisë në Këshillin e Qarkut Vlorë.**

##### **Ndiqet procedura si më poshtë.**

Ndërlkohet sjellja e këshilltarëve, dalin jashtë rendit të ditës. Këshilltarët e subjektit politikë Bashkë Fitojmë largohen nga salla e mbledhje. Prezent janë 13 këshilltarë.

Vazhdon mbledhja e këshillit me shqyrtimin e pikës së fundit të rendit të ditës.

Kryetari i këshillit propozon me votim të hapur zgjedhjen e këshilltarëve përfaqësues në këshillin e Qarkut Vlorë. Miratohet nga këshilltarët.

a- Kryetari i Këshillit citon numrin e këshilltarëve që do të përfaqësojnë këshillin e bashkisë në qark të cilët janë 4 (katër) së bashku me kryetarin e Bashkisë.

b- Kryetari i Këshillit kërkon propozimet konkrete për kandidatët për anëtarë të Këshillit të Qarkut.

Këshilltari Milto Nika propozon: Z.Qirjako Mërkuri

Këshilltarja Mirka Gjiçali propozon: Z. Maks Vlasi dhe Z.Gjergj Iliadhi

Kryetari: Ka propozime të tjera? Jo

Kryetari i Këshillit: I hedhim në votim kandidaturat për përfaqësuesit e këshillit në Këshillin e Qarkut.

**Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro, kundra jo, abstenim jo**

përfaqësues i Këshillit të Bashkisë në Këshillin e Qarkut Vlorë zgjidhen:

1. Qirjako Mërkuri

2. Maks Vlasi

3. Gjergji Iliadhi

**VENDIMI NR. 32 DATË 27.06.2023 "MBI ZGJEDHJEN E PËRFAQËSUESVE TË  
KËSHILLIT TË BASHKISË HIMARË NË KËSHILLIN E QARKUT VLORË"**

5. Mbyllja e mbledhjes nga Kryetari i Këshillit.

**Sekretari**

Elena Memushaj

